



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT - KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU - PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Rr. Ilir Konushevci, Nr. 8, 10000 Prishtinë
info@pak-ks.org – www.pak-ks.org

KOMUNIKATË PËR MEDIA

8 Shtator, 2010

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT SHBALL REZULTATET E VALËS 45 TË PRIVATIZIMIT

PRISHTINË – Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) sot në ceremoninë e hapjes së ofertave të valës 45 të privatizimit, shpalli fituesit e përkohshëm të Ndërmarrjeve të Reja të tenderuar përmes metodës së Spin-off-it të Rregullt.

Gjithsej 17 Ndërmarrje të Reja ishin në dispozicion për shitje.

Ofertat u pranuan në zyrat qendrore të AKP-së në Prishtinë nga ora 10:00 deri në ora 12:00.

Ceremonia e hapjes së ofertave dhe publikimi i rezultateve u zhvillua në Sallën e Kuqe të Pallatit të Rinisë dhe Sporteve, nga ora 13:00 deri në ora 14:00

Ofertat janë hapur dhe rezultatet janë shpallur në mënyrë transparente, para përfaqësuesve të medieve dhe investitorëve të pranishëm.

Gjithsej janë pranuar 69 oferta dhe vlera e tërësishme e ofertave më të larta ishte 13 milionë e 335 mijë e 756 euro.

Zëvendësdrejtoresha e AKP-së, znj. Mrika Tahiri njoftoi se deri më tani janë privatizuar 560 ndërmarrje të reja. Znj. Tahiri njoftoi gjithashtu se Agjencia ka bërë shpalljen e Valës së veçantë të privatizimit (Vala 45A), përmes të cilës janë hedhur për shitje 15 ndërmarrje të reja, që ndryshe mund të quhen ndërmarrje të mëdha, atraktive dhe të rëndësishme për ekonominë e vendit, si industri të tekstilit, miniera të boksitëve, fabrika të ndryshme, patundshmëri në lokacione kyqe të qyteteve të Kosovës etj.

“Agjencia pret interesim të madh të investitorëve për këto ndërmarrje të tenderuara, ndërsa ju sigurojmë edhe një herë se, ashtu si edhe deri më tani,

Për më shumë informata, ju lutemi kontaktoni Znj. Arta Gosalci në
038 500 400 lokali 1110 apo në arta.gosalci@pak-ks.org

procesi do të zhvillohet në mënyrë të hapur dhe transparent para investitorëve dhe opinionit në përgjithësi”, theksoi zëvendës drejtoresha e AKP-së.

Agjencia Kosovare e Privatizimit tani është duke punuar që të përfundoj të gjitha shitjet, në pritje të vendimit të Bordit të Drejtorëve të AKP-së.

Agjencia Kosovare e Privatizimit, është themeluar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës duke pas parasysh se rindërtimi dhe zhvillimi ekonomik i Kosovës dhe mirëqenia e qytetarëve të saj është me rëndësi jetike dhe kërkon administrimin dhe privatizimin ose likuidimin me kohë të ndërmarrjeve në pronësi shoqërore.

Agjencia Kosovare e Privatizimit ushtron funksionet dhe përgjegjësitë që ka në mënyrë plotësisht të pavarur dhe është e shtrirë dhe vepron në të gjithë territorin e Kosovës.

Është me rëndësi të ritheksohet përqendrimi i Agjencisë në përshejtimin e shpërndarjes së 20% të hyrave për punëtorët e ndërmarrjeve, ku deri më tani nga fondi i privatizimit, punëtorëve të Ndërmarrjeve Shoqërore iu janë shpërndarë mbi 27 milionë e 175 mijë Euro.

Nga privatizimi i këtyre ndërmarrjeve shoqërore deri më tani janë grumbulluar 456,930,761€ ndërkaq nga procesi i likuidimit me shitje të aseteve të ndërmarrjeve janë grumbulluar 22,417,307€

FUND